



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË

Nr. 40 Prot.

Tiranë, më 19. 01. 2018

Raport i aktivitetit të
Qendrës Kombëtare të Kinematografisë
për periudhën kohore
Janar – Dhjetor 2017

KRYETARI


Ilir BUTKA



Bul. "Aleksandër Moisiu", Nr.77, Tiranë
Tel/Fax. 04 2378 004
E-mail: info@nationalfilmcenter.gov.al
Website: www.nationalfilmcenter.gov.al

1. Përshkrim i përgjithshëm i aktivitetit dhe misionit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë (QKK)

QKK është institucion qendror, që ushtron aktivitetin në zbatim të ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, "Për kinematografinë", i ndryshuar si dhe aktet nënligjore të zbatim të tij. Misioni kryesor i QKK është financimi dhe promovimi i prodhimit kinematografik në Shqipëri, nëpërmjet administrimit të fondeve publike, me qëllim zhvillimin e industrisë së filmit në vendin tonë.

QKK, që prej krijimit të saj, mbështet prodhimin, distribuimin dhe promovimin e filmave me metrazh të gjatë, të shkurtër, dokumentar dhe të animuar. Nëpërmjet financimeve prioritet i jepet projekteve që garantojnë bashkëprodhim, kryesisht atyre ndërkombëtar. Kjo është një strategji efikase për të siguruar distribucion dhe audiencë për filmat edhe jashtë vendit.

QKK, gjithashtu, mbështet financiarisht festivale dhe javë filmi, organizon Ditë të Filmit Shqiptar në vende të tjera, seminare, work-shope e konferenca që kontribuojnë në zhvillimin e industrisë së filmit në Shqipëri, si dhe botimin e literaturës kinematografike.

QKK është përfaqësuese e Shqipërisë pranë strukturave ndërkombëtare kinematografike Eurimages, SEE, European Film Promotion, Creative Europe.

Skemat e klasike të financimit për projektet kinematografike që janë aplikuar prej vitesh në QKK kanë qenë:

- Film artistik i metrazhit të gjatë
- Film artistik i metrazhit të gjatë vepër e parë
- Film artistik i metrazhit të shkurtër
- Film dokumentar
- Film animacion

Lidhur me financimin e projekteve QKK ka ndjekur një politike të re e cila synon t'i përgjigjet kërkesave të reja që imponon zhvillimi kinematografik.

Për këtë qëllim u krijuan disa skema të reja financimi (si më poshtë) të cilat iu shtuan skemave klasike egzistuese:

Filmi Independent :

Film artistik i metrazhit të gjatë
Film artistik i metrazhit të shkurtër
Film dokumentar
Film i animuar

Në vitin 2017 pas procesit të vlerësimit fitojnë të drejtën për financim 48 projekte.

Më konkretisht :

- 4 Filma me metrazh të gjatë
- 7 Filma me metrazh të gjatë, vepër e pare
- 4 Filma me metrazh te gjate Minority coproduction
- 7 Filma me metrazh të gjatë Independent
- 7 Filma me metrazh të shkurtër
- 7 Filma me metrazh të shkurtër Independent
- 2 Filma me metrazh te shkurter pasprodhim
- 7 Filma Dokumentarë
- 1 Film Dokumentar Independent
- 1 Film i Animuar
- 1 Film i Animuar Independent

Skema e financimit për 'Bashkëprodhimet në minorancë' u aplikua për herë të parë në QKK (2015) për t'ju përgjigjur akumulimit të mungesës së financimit nga ana e Shqipërisë në projektet e përbashkëta me Kosovën dhe Maqedoninë duke krijuar një bilanc negativ në raport me financimin reciprok me këto dy vende.

Që prej aplikimit të kësaj skeme janë financuar gjithsej 9 projekte të kategorisë « minority co-production », ndërsa vetëm gjatë vitit 2017, në aplikimet sipas kësaj skeme janë financuar 4 projekte filmike, vendi i origjinës së të cilëve ishte si më poshtë vijon :

- 1 projekt nga Kosova
- 1 projekt nga Maqedonia
- 1 projekt nga Greqia
- 1 projekt nga Italia

2. Aktivitetet në fushën e kinematografisë për periudhën janar - dhjetor 2017.

Në periudhën janar - dhjetor 2017, Qendra Kombëtare e Kinematografisë ka zhvilluar këto aktivitete:

2.1 Premiera Filmash:

Janë përfunduar dhe kanë realizuar premierat për publikun 25 projekte filmike, si më poshtë vijon:

Filma artistikë metrazh të gjatë:

- **Të thyer** - skenari dhe regjia Edmond Budina
- **Dita zë fill** - skenari dhe regjia Gentian Koçi
- **Elvis kthehet në shtëpi** - skenari dhe regjia Fatmir Koçi
- **Bunker** - skenari dhe regjia Kastriot Hasa
- **Tuneli** (financuar për pasprodhim) - skenari dhe regjia Ilir Harxhi
- **Yjet e së ardhmes** - Independent, skenari dhe regjia Edmond Topi

Filma minority coproduction:

- **Martesa** - skenari Blerta Zeqiri, Kreshnik Berisha, regjia Blerta Zeqiri-premierë botërore.

Filma artistikë me metrazh të shkurtër:

- **I ardhur nga ëndrrat** - skenari dhe regjia Vladimir Prifti
- **ne kemi diellin** - skenari dhe regjia Petrit Ruka
- **shtëpia e vjetër** - skenari dhe regjia Genti Kame
- **E huaj** - skenari Shaban SINANI, regjia Donard Hasani
- **Tirana, 100 km** - skenari dhe regjia Lorin Terezi
- **Dieta" (113)** - skenari dhe regjia Vivian Rama
- **Ujë për trëndafila** (financuar për pasprodhim) - skenari dhe regjia Luli Bitri
- **Vëthi i munguar** (financuar për pasprodhim) - skenari dhe regjia Bujar Alimani

Filma dokumentarë:

- **I fundmi i rilindësve - Josif Bageri** - skenari Miradie Maliqi, Angelina Xhara, regjia Kujtim Gjonaj.
- **Mumtaz Dhrami, një jetë në bronx** - skenari dhe regjia Petrit Ruka.
- **Shenjat** - skenari Fatos Baxhaku, regjia Xhoslin Rama
- **Një ciceron për historinë** - skenari Roland Gjoza, regjia Saimir Kumbaro

- **Koha e pelikulës- Xhanfize Keko** - skenari dhe regjia Mevlan Shanaj
- **Lek Tasi** (independent) - skenari dhe regjia Ervin Çoba
- **Dritë** - skenari dhe regjia Yllka Gjollës
- **Saga e dinejve** - skenari Enver Kushi, Luan Rama, regjia Kujtim Gjona

Filma të animuar:

- **Kaini** - skenari dhe regjia Shaqir Veseli
- **Një histori** - Eridon PASHAJ, regjia Albana Shoshi
- **Ritual në errësirë** - skenari dhe regjia Elton Vogli
- **Sarah** - skenari dhe regjia Artan Maku

2.2 Pjesëmarrje e QKK në festivale filmi (kombëtare dhe ndërkombëtare):

Festivale ndërkombëtare brenda vendit gjatë vitit 2017:

- Festivali Ndërkombëtar i Filmit “DEA Film Fest”, Edicioni IV, Sarandë, Korrik.
- Festivali Ndërkombëtar i Filmit dhe Kulinarisë, Pogradec, Korrik.
- Festivali Ndërkombëtar i Filmit “A-Film Fest Argjiro- Rozafa”, Maj Gjirokaster dhe Shtator Shkodër.
- Festivali Ndërkombëtar i Filmit “TIFF”, Tirane, Nëntor.
- Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut, Shtator
- Festivali Ndërkombëtar i Filmit për Studentë dhe Rinj “First Step Film Fest”, Shtator.
- Festivali Ndërkombëtar i Filmit “Giffoni - Albania”, Tiranë, Durrës, Shkodër.

Festivale ndërkombëtare jashtë vendit 2017

- Festivali i Filmit ne Berlin, Shkurt.
- Festivali i Filmit në Prishtinë, Prill.
- Festivali i Filmit në Kanë, Maj.
- Festivali i Filmit në Sarajevë, Korrik ku kineastët shqiptarë morën pjesë në premierën botërore të filmit “Dita zë fill”, të regjisorit Gentian Koçi, gjatë të cilit aktorja kryesore e filmit Ornela Kapetani fiton çmimin “**Zemra e Sarajevës -Aktorja më e mirë**” .
Gjithashtu, gjatë këtij aktiviteti u organizua takimi i drejtuesve të institucioneve që operojnë në fushën e audiovizualit.

2.3 Aktivitete të tjera ndërkombëtare:

1. Pjesëmarrja e regjisorit të filmit shqiptar “Dita zë fill” në festivalin ndërkombëtar të Varshavës në Tetor dhe në festivalin ndërkombëtar të filmit në Stokholm - Nëntor.
2. Pjesëmarrja e producentit Genc Përmeti në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit të Tel Aviv, Izrael për promovimin e filmit “Tomka dhe shokët e tij” të regjisores së mirënjohur për filma për fëmijë Xhanfise Keko.
3. Pjesëmarrja në regjisorëve të rinj Gledis Bica dhe Kejdi Demneri në Festivalin Ndërkombëtar “Go Short” në Hollandë, Mars.
4. Pjesëmarrje e përfaqësuesve të QKK në mbledhjet e organizuara nga Eurimages katër herë në vit.

Festivale ndërkombëtare jashtë vendit për vitin 2017:

1. Stenda e kinematografisë shqiptare në Festivalin e Filmit në Berlin, Shkurt.
2. Stenda e kinematografisë shqiptare në Festivalin e Filmit në Kanë.
3. Pjesëmarrja e producentes Belina Jano në “EAVE”, në Kopenhagen.
4. Pjesëmarrja e Kryetarit të QKK Ilir Butka, në “Festivalin e Venecias” për promovimin e Kinematografisë shqiptare.
5. Pjesëmarrja dhe prezantimi i Balkan Film Market nga Kryetari i QKK Ilir Butka dhe drejtori i BFM Andamion Murataj në “MIA-Italian Market of Audiovisual”, Romë, Itali.
6. Pjesëmarrja e Kryetarit të QKK Ilir Butka dhe drejtorit të Media Desk Albania Arben Papadhopullit, në mbledhjen e rradhës së SEE si dhe në “Festivalin e Selanikut” Greqi.
7. Pjesëmarrje në Otranto Film Fund Festival
8. Pjesëmarrje në festivalin më të rëndësishëm mesdhetar Carthage Film Festival, Tuniz.

Projekte të ndryshme për vitin 2017:

1. Organizimi në Tiranë (2-7 tetor 2017) i edicionit të parë të Balkan Film Market, event ky i mbështetur nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë dhe Creative Europe - Media Desk Shqipëri, nën patronazhin e Eurimages.

Balkan Film Market u bë i mundur nga mbështetja e Ministrisë së Kulturës, Shqipëri dhe MiBACT – Ministero dei Beni e delle Attività Culturali e del Turismo, Itali.

Më shumë se 220 përfaqësues të industrisë së filmit nga 18 vende të ndryshme morën pjesë në seksionet e mëposhtme:

- ❖ Creative Europe / Media
 - ❖ Albascript +
 - ❖ Pitch Balkan
 - ❖ Minority Co-productions
 - ❖ Masterclasses: 3
 - ❖ Panels: 17
- Albascript+ është një program i zhvillimit të skenarit, i organizuar për herë të dytë gjatë BFM, ku morë pjesë 11 projekte të filmit të gjatë dhe 5 projekte të filmit të shkurtër.
- 13 projekte të filmit të gjatë, të cilët kishin siguruar financim (të pjesshëm) u përzgjodhën për të marrë pjesë në PITCH BALKAN:
- ❖ 3 me origjinë shqiptare
 - ❖ 3 me origjinë serbe
 - ❖ 2 me origjinë greke
 - ❖ 2 me origjinë kosovare
 - ❖ 1 me origjinë maqedonas
 - ❖ 1 me origjinë çeko/kroate
 - ❖ 1 me origjinë bullgare

Fituesit e PITCH BALKAN

- **Çmimi I-rë** : SNOW WHITE DIES IN THE END, regjisor Kristijan Risteski, producent Darko Popov, Maqedonia
- **Çmimi II-të**: SUNBURN, regjisor Slobodanska Radun, producent Danny Holman, Republika Çeke/Kroacia
- **Çmimi III-të**: THERE WILL BE HELL TO PAY, regjisor Gvozden Djuric, producent Uros Tomic, Serbia

Në Balkan Film Market morën pjesë :

- ❖ 50 producentë
- ❖ 12 distributorë
- ❖ 5 workshope (filmi)
- ❖ 11 festivale filmi
- ❖ 20 vendimmarrës

2. Përkujtimore në 80-vjetorin e lindjes së regjisorit Viktor Gjika, Qershor - Tiranë.
3. Përkujtimore në 85-vjetorin e lindjes së aktorese Tinka Kurti, Dhjetor - Tiranë.
4. Financimi i botimit të librit Xhanfise Keko – An Albanian Woman Film Director.

FONDE ALTERNATIVE TË SIGURUARA GJATË VITIT 2017

1. Nëpërmjet programit *Interreg IPA Cross-border Cooperation Programme "Italy-Albania-Montenegro"* u gjetën fondet alternative për realizimin e projektit pilot (një nismë që kjo prej vitit 2015) për hapjen e kinemave fillimisht në qytetin e Gjirokastrës dhe Vlorës për të vazhduar më tej në qytete të tjera të Shqipërisë si Pogradec, Shkodër, Sarandë, etj. dhe sigurimin e mjeteve teknike për funksionimin e tyre.
2. Janë financuar nga Eurimages 3 projekte filmike të metrazhit të gjatë
3. Janë financuar nga SEE Cinema Network 2 projekte filmike (një me metrazh të gjatë dhe një me metrazh të shkurtër)
4. Është financuar nga Creative Europe/Media Desk një projekt kinematografik (Online Distribution).
5. Ndërkohë që të gjithë projektet e filmave me metrazh të gjatë kanë siguruar fonde nga bashkëprodhuesit e huaj.

Ndërkohë po punojmë për projektet e mëposhtme:

Në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë po punojmë për implementimin e një skeme të re financimi për realizimin e mbështetjes për produksionet e huaja që duan të realizojnë xhirimet në territorin shqiptar.

Po punojmë për krijimin e Albanian Film Commission në bashkëpunim me pushtetin lokal dhe shtrirjen e saj në qytetet kryesore të Shqipërisë.

Çfarë do bëhet gjatë 2018

Edicioni i dytë i Balkan Film Market gjatë të cilit do zhvillohen:

- Edicioni i tretë i Albascript
- Edicioni i dytë i Pitch Balkan
- Mbledhja e SEE Cinema Network (e konfirmuar nga organizatorët)
- Festivali Shqiptar i Filmit

2.4 Detyra funksionale (administrative)

- Ngritja e Komisionit Përzgjedhës të Filmit për OSCAR.

2.5 Plan Buxheti

Buxheti për vitin 2017, në total 167 milion lekë, prej të cilave:

- mbështetje ekonomike për projektet kinematografike - 130.5 milion lekë;
- investime 2 milion lekë.

2.6 Të ardhurat

Të ardhurat dytësore janë realizuar 6 milion lekë, të cilat derdhen 100% në buxhetin e shtetit.